

## Auditimet Energjetike - mjeti ynë falas për të vlerësuar kursimin tuaj të energjisë

Auditimi i energjisë ju ndihmon të kuptoni situatën tuaj të tanishme të energjisë dhe të vlerësoni kursimin e energjisë që ju mund të arrini me një investim të planifikuar.

Për t'u kualifikuar për produkte të kredive "të gjelbëra" nga banka jonë, është i nevojshëm një auditim i energjisë - por kjo gjë nuk do t'ju kushtojë asgjë.

Auditimet energjetike kryhen nga ekspertë vendorë të energjisë që kanë përvojë të gjatë në fushën e efikasitetit të energjisë. Ata jo vetëm që mund të vlerësojnë ndikimin në kursim të energjisë të një investimi, por gjithashtu janë në gjendje t'ju këshillojnë edhe për mënyra të tjera të zvogëlimit të shpenzimeve tuaja të energjisë.

Një auditor i energjisë ose këshilltar i energjisë nuk është i interesuar në asnjë detaj financiar të biznesit tuaj, por vetëm shqyrton gjendjen e ndërmarrjes suaj nga pikpamja energjetike.

Kjo fletushkë informuese ju ofron një pasqyrë të procesit të auditimit të energjisë dhe kërkesat përkatëse.



DISA FJALË RRETH FONDIT PËR RITJEN NË MËNYRË TË GJELBËRT, PËR EUROPËN JUGLINDORE (GGF)  
Fondi për Rritjen në mënyrë të gjelbërt – për Europën Juglindore, është fondi i parë i specializuar për të avancuar në rritjen e efikasitetit të energjisë (EE) dhe shfrytëzimin e burimeve të rinovueshme (të ripërtëritshme) të energjisë (ER) në Europën Juglindore, përfshirë Turqinë, si dhe rajonin fqinj të Europës Lindore. Si iniciativë e Bankës Europiane të Investimeve dhe KfW Bankës për Zhvillim (Entwicklungsbank), GGF është një partneritet inventiv publiko-privat i themeluar për të reduktuar konsumin e energjisë dhe të emetimit të CO<sub>2</sub>. GGF ofron ri-financim për Institucionet Financiare për të rritur pjesëmarrjen e tyre në sektorët e EE dhe ER dhe gjithashtu bën investime të drejtpërdrejta edhe në Institucionet jo-financiare me projekte në këto fusha. Aktivitetet e GGF janë të mbështetura nga Pjesa e Asistencës Teknike.



© 2014 GGF Technical Assistance Facility



Ky projekt financohet nga Bashkimi Europian.

## KURSENI ENERGJINË, ULNI SHPENZIMET, SHFRYTËZONI FALAS AUDITIMET ENERGJETIKE




## Përparësitë e të investuarit në efikasitetin e energjisë

Politikat rreth energjisë dhe çmimet në rritje të energjisë janë duke u diskutuar në shumicën e vendeve.

Megjithëse çmimet e energjisë në vendin tonë janë ende relativisht të ulëta, kjo mund të ndryshojë në të ardhmen, pasi energjia është një pasuri gjithnjë e më e rrallë dhe qeveritë zakonisht subvencionojnë shumën të lartë për të mbajtur çmime të ulëta për konsumatorët.

Ekziston një ndërgjegjësim në rritje e sipër në komunitetin e biznesit se ekzistojnë disa përparësi konkurruese që mund të fitohen nga shfrytëzimi më i vogël i energjisë. Prandaj nuk është për t'u habitur që gjithnjë e më shumë biznese janë duke investuar në teknologjitë për të rritur efikasitetin e energjisë, e në mënyrë që, përpos uljes së shpenzimeve, të përfitojnë nga përparësitë e mëposhtme:

- Shpenzime më të ulëta të mirëmbajtjes
- Produktivitet më i lartë
- Konkurrencë e përmirësuar
- Qëndrueshmëri më e madhe
- Rritje e jetëgjatësisë së pajisjeve




## Auditimet e domosdoshme të energjisë për produkte të veçanta të kredisë “së gjelbër”

Auditimet tona të domosdoshme të energjisë ju mundësojnë që të zbuloni nëse investimi juaj i planifikuar do të përmbushë kushtet për produktet tona të veçanta të kredisë “të gjelbëra”. Me fjalë të tjera, auditori i energjisë do të vlerësojë nëse projekti juaj do të arrijë kursimet e nevojshme të energjisë apo do të reduktojë emetimet e CO<sub>2</sub> sa i përket kufijve të kërkuar. Lloji i auditimit të energjisë do të varet nga lloji dhe madhësia e projektit. Diagrami më poshtë ju tregon se cili lloj auditimi i energjisë është i përshtatshëm për produktin tuaj të kredisë së “gjelbër”:



### Projekti është një zëvendësim i thjeshtë i pajisjeve apo makinerisë

#### Auditime Energjetike të Thjeshta



#### Çfarë?


Auditimet e thjeshta zakonisht kryhen për projektet e zëvendësimit të drejtpërdrejtë të pajisjeve, p.sh. zëvendësimin e makinës CNC (makinë metalprerëse e kompjuterizuar).

#### Në ç'mënyrë?

Në shumicën e rasteve këto auditime kryhen në distancë (pa bërë vizitë në ndërmarrje) nga ana e audituesit/konsulentit për energjinë bazuar në dokumentet tuaja që përshkruajnë pajisjet ekzistuese dhe ato të reja. Vizita në vendndodhjen tuaj është e nevojshme vetëm kur mungon ky dokumentacion. Auditimet e thjeshta zakonisht zgjasin deri në 3 ditë pune, dhe zhvillohen në të njëjtën kohë kur edhe banka është duke përpunuar kërkesën tuaj për kredi.

### Projekti përfshin ndryshime më komplekse të procesit të prodhimit (apo shërbimeve)

#### Auditimi Energjetik i Detajuar



#### Çfarë?

Auditimet e detajuara janë të nevojshme për projektet më komplekse të kursimit të energjisë, siç janë përmirësimet e procesit apo zëvendësimit të më shumë pajisjeve p.sh. futja e skemave kogjeneruese (prodhimi i përbashkët i energjisë termike dhe elektrike) ose remonte të sistemeve të ngrohjes industriale.

#### Në ç'mënyrë?

Për këto auditime, audituesi/konsulenti për energji zakonisht do të kërkojë qasje në objektet tuaja në mënyrë që të mbledhë informacionin e nevojshëm për të llogaritur me saktësi kursimet e energjisë. Auditimet e detajuara zakonisht zgjasin deri në 6 ditë pune, dhe zhvillohen në të njëjtën kohë kur edhe banka është duke përpunuar kërkesën tuaj për kredi.

### A është kredia më tepër se 500,000€ (EUR)?

#### Auditime Energjetike pasi janë realizuar (implementuar) masat (ex-post)



#### Çfarë?

Nëse kredia juaj është mbi 500.000€, banka duhet të kontrollojë nëse masat e planifikuara të kursimit të energjisë janë zbatuar ashtu siç është propozuar, dhe nëse janë duke u arritur kursimet e parashikuara.

#### Në ç'mënyrë?

Auditimi Energjetik pasi janë implementuar masat (ex-post) duhet të kryhet në vendndodhjen tuaj, pasi qëllimi është që të konfirmohet vizualisht se a janë zbatuar me sukses masat ashtu siç është planifikuar. Ky lloj i auditimit kryhet vetëm pasi projekti të jetë zbatuar plotësisht.

## Auditimet Energjetike Holistike falas

Auditimet Energjetike Holistike janë një shërbim falas i ofruar nga banka jonë dhe i financuar nga Fondi për Rritjen në Mënyrë të Gjelbërt. Një auditim i tillë i energjisë do t'ju ndihmojë që të identifikoni mundësitë e kursimit të energjisë në veprimtarinë tuaj dhe në këtë mënyrë do të zbulohen mundësitë për rritjen e prodhimit tuaj, përmirësimin e cilësisë së produktit tuaj ose reduktimin e emisioneve tuaja duke zvogëluar shpenzimet tuaja të energjisë.

Hapat e mëposhtëm të thjeshtë do të kryhen nga një auditues/konsulent i energjisë për të analizuar situatën tuaj aktuale të energjisë dhe për të ofruar rekomandime të dobishme në lidhje me zhvillimet tuaja në të ardhmen. Audituesit/konsulentit për energji:

